VENDIM
Nr.984, datë 1.12.2010

PËR LEJIMIN E DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, SI AUTORITETE KONTRAKTORE, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e disa institucioneve në varësi të ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si autoritete kontraktore, të vazhdojnë procedurat e prokurimit, brenda vitit 2010, si më poshtë vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si autoritet kontraktor, për këto objekte:

- Ndërtim rruga "Unaza e Re e Tiranës-Mullet, loti 1",
- Ndërtim rruga e Arbërit (segmenti Dalje U.Vashës-Bulqizë), loti 3;
- Ndërtim rruga "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, loti 4";
- Ndërtim rruga "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, loti 8";
- Studim – projektim rruga "Tiranë-Dajt-Qafëmollë";
- Studim – projektim, zgjerim i rrugës "Sukth-Hamallaj";
- Studim–projektim–ndërtim, rrugët paralele, segmenti "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë";
- Studim – projektim – ndërtim, rruga "Tiranë-Elbasan" (dublimi dhe plotësimi i segmentit Ibë-Elbasan).

b) Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Mallakastër, si autoritet kontraktor, për objektin "Ndërtimi i stacionit të pompimit në Qafën e Kashit";

c) Porti Detar, Shëngjin, si autoritet kontraktor, për objektin "Survejimi topografik dhe batimetrik, analizimi i gjendjes së dherave dhe integrimi i vlerësimit mjedisor, për rehabilitimin e Portit Detar, Shëngjin dhe thellimi i kanalit hyrës të portit".

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Mallakastër, Porti Detar, Shëngjin dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha